

LIGJ
Nr. 65/2014

PËR AGJENCINË E INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat dhe fushën e veprimtarisë së Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si dhe rregullon pozitën juridike e administrative, karrierën, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e punonjësit të kësaj agjencie.

Neni 2

Misioni

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes mbështet autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura dhe Forcat e Armatosura me inteligjencë në fushën e zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë, në përmbushje të misionit të tyre kushtetues.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij, ku kryejnë mision Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në zonat e interesit ose zonat e përgjegjësisë nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ushtron kompetencat e saj mbi veprimtari që lidhen me kërcënime ose rreziqe që synojnë të cenojnë ose cenojnë Forcat e Armatosura në realizimin e misionit të tyre kushtetues.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Inteligjencë” është informacioni përfundimtar, i përftuar nga procesi i përpunimit, analizimit e vlerësimit të të dhënave dhe informacionit të natyrës së zbulimit, kundërzbulimit e sigurisë, objekt i fushës së veprimtarisë së Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. “Zbulim” është veprimtaria që ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave ose informacionit për kërcënime dhe rreziqe që vijnë nga jashtë, që synojnë të cenojnë ose cenojnë Forcat e Armatosura.

3. “Kundërzbulim” është veprimtaria që ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave ose informacionit për kërcënime dhe rreziqe që vijnë nga brenda, nga shërbime të huaja të inteligjencës, organizata ose individë të përfshirë në spiunazh, sabotazh, subversion, terrorizëm ose krim të organizuar, që synojnë të cenojnë ose cenojnë Forcat e Armatosura, si dhe kundërveprimin ndaj tyre.

4. “Siguri” është veprimtaria që konsiston në grumbullimin e të dhënave ose informacionit për veprimtari që cenojnë ose synojnë të cenojnë sigurinë fizike të personelit, të informacionit, të rrjeteve të komunikimit, shkëmbimit, transmetimit të informacionit të klasifikuar “sektet shtetëror” ose të NATO-s.

5. “Kërkesa strategjike vjetore për inteligjencë” janë nevojat për mbështetje me inteligjencë që kanë autoritetet e komandimit e të drejtimit të Forcave të Armatosura dhe institucionet e tjera të vendit ose të huaja, ku Shqipëria është palë, për zbulim, kundërzbulim dhe siguri në fushën e mbrojtjes.

6. “Zonë përgjegjësie” është hapësira gjeografike ku kryejnë mision Forcat e Armatosura, në të cilën Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është përgjegjëse të grumbullojë dhe të prodhojë inteligjencë, në përmbushje të misionit të saj.

7. “Zonë interesi” është hapësira gjeografike, për të cilën kërkohet prodhim inteligjence, në përmbushje të misionit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

8. “Qendër inteligjence” është një strukturë ose njësi e përkohshme dhe e lëvizshme që krijohet dhe funksionon jashtë vendit, në kuadër të komandave operacionale të Forcave të Armatosura.

9. “Operacion” është tërësia e veprimeve të organizuara, sipas një ideje për të zgjidhur detyra të caktuara strategjike dhe operative.

10. “Fondi specifik operativ” është pjesa e buxhetit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes që përdoret për të shpërblyer burimet e informacionit, shpenzimet për sigurimin e operacionit, blerjen dhe marrjen me qira të objekteve e të mjeteve në funksion të veprimtarive operative.

11. “Verifikimi i pastërtisë së figurës së personelit” është proces verifikimi, shqyrtimi dhe vlerësimi, që i referohet kryerjes së një kontrolli të kujdesshëm dhe kritik për një individ apo subjekt, përpara se atij t’i ofrohet një punë e rëndësishme që kërkon ruajtjen e sekretit, besueshmërinë, besnikërinë e përshtatshmërinë për një detyrë që ka të bëjë me sigurinë kombëtare.

12. “Kushti i sigurisë” është kontrolli paraprak për përshtatshmërinë e personit që aplikon për t’u pranuar në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

13. “Certifikatë sigurie” është dokumenti i lëshuar nga autoriteti përkatës shtetëror i sigurisë, pas kryerjes së procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës, që identifikon individin ose subjektin për të pasur të drejtë njohjeje me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” ose të NATO-s.

14. “Punonjës” është shtetasi shqiptar, ushtarak ose civil, që plotëson kriteret e arsimit dhe kualifikimit përkatës, sipas kërkesave të këtij ligji, dhe që është pranuar në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

15. “Nevojë për njohje” është nevoja e njohjes së punonjësit ose subjektit me informacion të klasifikuar “sekret shtetëror” ose të NATO-s, për shkak të funksionit dhe kryerjes së detyrës.

Neni 5

Parimet e veprimtarisë

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes organizohet dhe funksionon në bazë të këtyre parimeve:

- a) ligjshmëria;
- b) objektiviteti dhe paanësia;
- c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- ç) asnjënjësia politike;
- d) menaxhimi dhe kontrolli i centralizuar;
- dh) bashkëveprimi ndërinstytucional;
- e) ruajtja e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, formave dhe metodave të punës;
- ë) kontrolli dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së saj.

KREU II

ORGANIZIMI I AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Neni 6

Organizimi

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Mbrojtjes.

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes organizohet në nivel drejtorie të përgjithshme dhe funksionon në mënyrë të centralizuar, me struktura vartëse në territorin ku kryejnë veprimtari dhe mision Forcat e Armatosura, brenda dhe jashtë vendit, sipas zonave të përgjegjësisë dhe zonave të interesit.

2. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ka stemën dhe flamurin e vet, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

3. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes mban numrin kodik dhe atë luftarak, sipas përcaktimeve të autoriteteve ushtarake.

4. Struktura dhe organika analitike e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

5. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për ruajtjen, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve të krijuara gjatë veprimtarisë së saj, ka arkivin e vet, që funksionon sipas legjislacionit në fuqi për arkivat dhe për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

Neni 7

Detyrat e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes kryen këto detyra:

- a) përpunon kërkesat strategjike vjetore për inteligjencë;
- b) paraqet, nëpërmjet Ministrit të Mbrojtjes, produkt inteligjence gjithëburimshe, të nivelit strategjik, për autoritetet e komandimit të Forcave të Armatosura, në përputhje me parimin “nevojë për njohje”;
- c) paraqet, nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes produkt inteligjence gjithëburimshe, të nivelit operacional, për autoritetet e tjera të drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura, në përputhje me parimin “nevojë për njohje”;
- ç) grumbullon, përpunon, vlerëson, analizon dhe shpërndan të dhëna e informacione, si dhe paraqet produkt inteligjence gjithëburimshe për Ministrin e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, lidhur me sisteme mbrojtjeje, grupe e organizata me kapacitete kërcënuese të vendeve të huaja, aktivitete të subjekteve, të cilat mund të kërcënojnë ose të rrezikojnë veprimtarinë e Forcave të Armatosura;
- d) merr pjesë në procedurat për pajisjen me “certifikatë sigurie” të personelit ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes, të Forcave të Armatosura dhe “certifikatë sigurie industriale” të subjekteve që kërkojnë të hyjnë në marrëdhënie me to;
- dh) grumbullon, përpunon, vlerëson, analizon, shpërndan të dhëna e informacione dhe paraqet produkt inteligjence gjithëburimshe për Ministrin e Mbrojtjes, lidhur me kërcënime të natyrës së terrorizmit, ekstremizmit, spiunazhit, sabotazhit, diversionit, subversionit, armëve të shkatërrimit në masë, kërcënimeve kibernetike e krimit të organizuar ndaj kapaciteteve mbrojtëse të vendit;
- e) prodhon produkt inteligjence dhe shpërndan të dhëna në interes të operacioneve të Forcave të Armatosura dhe misioneve jashtë vendit, ku janë përfshirë kontingjentet dhe misionet ushtarake shqiptare;
- ë) paraqet produkt inteligjence për gjendjen e sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Forcat e Armatosura;
- f) shkëmben produkt inteligjence, bashkëpunon dhe kryen operacione të përbashkëta me struktura të inteligjencës së NATO-s dhe BE-së, me shërbime dhe me agjenci të inteligjencës së vendeve anëtare të NATO-s e të BE-së dhe agjencitë partnere në interes të mbrojtjes kolektive;
- g) garanton sigurinë e veprimtarisë së vet, të personelit, të informacionit, infrastrukturës dhe të sistemeve të komunikimit, shkëmbimit, transmetimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” ose të NATO-s;
- gj) kontribuon me personel, inteligjencë dhe qendra inteligjence në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në NATO, BE, OKB dhe në çdo organizëm tjetër ndërkombëtar ku shteti shqiptar është ose synon të bëhet palë;
- h) organizon dhe kryen arsimim dhe trajnim profesional për punonjësit e strukturave të inteligjencës ushtarake, në kuadër të sistemit arsimor të Ministrisë së Mbrojtjes, të NATO-s dhe në kuadër të bashkëpunimit me shërbimet homologe dhe partnere;
- i) kryen detyra të tjera brenda misionit të saj, të përcaktuara në rregulloren e funksionimit të kësaj Agjencie.
- j) në zbatim të shkronjave “ç”, “dh”, “e”, “ë” dhe “f”, Ministri i Mbrojtjes miraton rregullore me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie.

Neni 8

Ministri i Mbrojtjes

1. Ministri i Mbrojtjes është autoriteti më i lartë përgjegjës për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. Ministri i Mbrojtjes raporton para Kryeministrit për drejtimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Ministri i Mbrojtjes ushtron këto kompetenca mbi veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes:

- a) përcakton përparësitë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, bazuar në politikën shtetërore

dhe miraton, çdo fillim viti, kërkesat strategjike vjetore për inteligjencë për këtë Agjenci;

b) përcakton zonat e përgjegjësisë dhe zonat e interesit, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

c) informon Kuvendin, Presidentin e Republikës dhe Kryeministrin për aktivitetin e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

ç) miraton politikat në fushat e zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

d) nxjerr urdhra dhe udhëzime në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi;

dh) jep plotfuqi për Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dy ose shumëpalëshe me strukturat e inteligjencës brenda dhe jashtë vendit;

e) miraton tabelën e organizimit dhe të pajisjeve (TOP) të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie;

ë) emëron, liron ose shkarkon nga detyra, komandon, nxjerr në rezervë apo lirim punonjës in ushtarak oficer, dhe emëron, liron ose shkarkon nga detyra punonjës in civil, ekuivalent me oficer sipas tabelës së organizimit të pajisjeve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie;

f) miraton krijimin e qendrave të inteligjencës, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

g) miraton kryerjen e operacioneve të veçanta me struktura të inteligjencës së NATO-s dhe të BE-së, me shërbime e agjenci të inteligjencës së vendeve anëtare të NATO-s e të BE-së, si dhe me agjencitë partnere në interes të mbrojtjes kolektive;

gj) miraton rregullat e funksionimit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të saj.

Neni 9

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është autoriteti më i lartë drejtues dhe përgjegjës për veprimtarinë e institucionit.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes këshillon Ministrin e Mbrojtjes dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për çështje të zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë së mbrojtjes.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është ushtarak aktiv.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra nga Ministri i Mbrojtjes.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është autoriteti që përfaqëson strukturat e inteligjencës ushtarake shqiptare në marrëdhëniet me institucionet brenda vendit, NATO-n, BE-në dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) drejton, organizon dhe menaxhon veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi;

b) siguron zbatimin e ligjshmërisë për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi;

c) zbërthen dhe zbaton direktivën e Ministrit të Mbrojtjes për çështjet e zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë në fushën e mbrojtjes;

ç) organizon punën për përmbushjen e kërkesave strategjike vjetore për inteligjencë;

d) informon dhe bashkëpunon me autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura për çështje që kanë lidhje me kërcënime të natyrës së zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë;

dh) informon Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, komandantët e forcave,

komandantët e komandave mbështetëse dhe komandantët e njësive ushtarake për çështje të zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë në fushën e mbrojtjes, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë;

- e) raporton te Ministri i Mbrojtjes për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- ë) i propozon Ministrit të Mbrojtjes krijimin e qendrave të inteligjencës, duke vënë në dijeni më parë Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- f) propozon tabelën e organizimit dhe pajisjeve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- g) emëron, liron ose shkarkon nga detyra, komandon punonjës in ushtarak nënoficer dhe ushtar dhe punonjës in civil, ekuivalent me punonjës in ushtarak, nënoficer dhe ushtar, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- gj) nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit dy ose shumëpalëshe me strukturat e inteligjencës brenda dhe jashtë vendit, me miratimin e Ministrit të Mbrojtjes;
- h) nxjerr urdhra dhe udhëzime të karakterit ushtarako-administrativ brenda kompetencave të tij;
- i) kryen detyra të tjera, të përcaktuara në akte të tjera ligjore e nënligjore.

Neni 11

Kriteret për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes emërohet personi që, përveç kriterëve të përcaktuara në nenin 31, të këtij ligji, plotëson edhe këto kriterë:

- a) të ketë shërbyer për një periudhë kohore jo më pak se 15 vjet në struktura të inteligjencës ushtarake apo në institucione me natyrë të ngjashme me to, nga të cilat jo më pak se 10 vjet në pozicione drejtuese;
- b) të ketë kryer ciklin e parë të studimeve të larta ose ciklin e dytë të studimeve të larta në fushën e inteligjencës ose sigurisë;
- c) të ketë kualifikime në fushën e inteligjencës ose sigurisë.

Neni 12

Zëvendës drejtorët e përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

1. Zëvendës drejtorët e përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra nga Ministri i Mbrojtjes.
2. Zëvendës drejtorët e përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes janë ushtarakë aktivë ose civilë.
3. Në çdo rast, një nga zëvendës drejtorët e përgjithshëm është civil.
4. Në rast të mungesës së Drejtorit të Përgjithshëm, ai zëvendësohet nga njëri prej zëvendës drejtorëve të përgjithshëm.

Neni 13

Kriteret për emërimin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm

Zëvendës drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes emërohet personi që, përveç kriterëve të përcaktuara në nenin 31, të këtij ligji, plotëson edhe këto kriterë:

- a) të ketë shërbyer për një periudhë jo më pak se 10 vjet në struktura të inteligjencës ushtarake ose civile apo në institucione me natyrë të ngjashme me to, nga të cilat jo më pak se 6 vjet në pozicione drejtuese;
- b) të ketë kryer ciklin e parë të studimeve të larta ose ciklin e dytë të studimeve të larta në fushën e inteligjencës ose sigurisë;
- c) të ketë kualifikime në fushën e inteligjencës ose sigurisë.

Neni 14

Lirimi ose shkarkimi nga detyra i Drejtorit të Përgjithshëm dhe i zëvendës drejtorit të përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm ose zëvendës drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes lirohet nga detyra nga autoriteti që e ka emëruar, nëse:

- a) plotëson moshën për pension të plotë pleqërie;
- b) del në rezervë ose lirim nga shërbimi ushtarak;
- c) nuk mund të ushtrojë detyrën për një periudhë kohore më të gjatë se 6 muaj;
- ç) emërohet në një detyrë tjetër.

2. Drejtori i Përgjithshëm ose zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes shkarkohet nga detyra nga autoriteti që e ka emëruar, nëse:

- a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- b) nuk ushtron detyrën në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) kryen akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij.

KREU III

VEPRIMTARIA E AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Neni 15

Marrëdhëniet e bashkëpunimit

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes bashkëpunon në fusha me interes reciprok, me institucione homologe dhe partnere të inteligjencës dhe sigurisë, të huaja dhe të vendit, si dhe me institucione brenda vendit, duke lidhur marrëveshje dy ose shumëpalëshe.

2. Përparësitë, fushat dhe nivelet e bashkëpunimit miratohen nga Ministri i Mbrojtjes, në përputhje me politikën shtetërore, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 16

Qendrat e inteligjencës

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, krijon qendra inteligjence që funksionojnë jashtë vendit në mënyrë të përkohshme, në zona përgjegjësie dhe zona interesi ku kryhen misione dhe operacione ushtarake në mbështetje të Forcave të Armatosura.

2. Qendrat e inteligjencës krijohen me miratimin e Ministrit të Mbrojtjes.

3. Procedurat e funksionimit të qendrës së inteligjencës përcaktohen me rregullore të miratuar nga ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 17

Burimet e informacionit

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në përmbushje të misionit të saj, përdor dhe shfrytëzon për grumbullim informacioni:

- a) burime njerëzore;
- b) burime sinjalore;
- c) burimet e hapura;
- ç) burime hartografike dhe fotografike.

2. Burimet sinjalore të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes grumbullojnë informacion vetëm me natyrë zbulimi jashtë vendit.

Neni 18

Grumbullimi i informacionit

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, siguron informacionin e nevojshëm nëpërmjet:

- a) bashkëpunimit me individë me vullnetin e tyre të lirë;
- b) përdorimit të mbikëqyrjes së fshehtë;
- c) krijimit dhe përdorimit të evidencës operative;
- ç) përdorimit të mjeteve teknike dhe elektronike;
- d) përgjimeve të telekomunikimeve;
- dh) kontrollit postar.

2. Procedurat specifike lidhur me shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç”, të pikës 1, të këtij neni, miratohen me rregullore të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm, të propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Mënyra e përdorimit të procedurave specifike përcaktohet me hollësi në rregulloren e linjës informative

që miratohet nga Ministri i Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

4. Përgjimi i telekomunikimeve dhe kontrolli postar për sigurimin e informacionit të nevojshëm bëhet sipas legjislacionit në fuqi për përgjimin e telekomunikimeve.

Neni 19

Përdorimi i identitetit të dyfishtë

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ose individ i qm merr pjesë në operacione të fshehta të kësaj Agjencie mund të përdorë identitet të dyfishtë, në mënyrë të përkohshme, me qëllim garantimin e sigurisë së operacionit.

2. Procedurat për pajisjen, mbajtjen dhe përdorimin e identitetit të dyfishtë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Mbrojtjes dhe Ministrisë të Punëve të Brendshme, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Kur individit ose punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, qm merr pjesë në operacione të fshehta dhe përdor identitet të dyfishtë, për shkak të detyrës ose bashkëpunimit, i kërcënohet jeta, shëndeti, familja apo prona, i garantohet mbrojtje e veçantë ligjore me urdhër të Ministrisë të Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

4. Mënyrat dhe kriteret e mbrojtjes së veçantë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes.

Neni 20

Burimet financiare

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ka dhe përdor buxhetin e vet, brenda buxhetit të miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Aktet ligjore e nënligjore në fuqi për përdorimin dhe kontrollin e fondeve publike nuk zbatohen për veprimtari specifike operative të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Përdorimi dhe kontrolli i fondeve për veprimtari specifike operative përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes.

Neni 21

Ndalimi i veprimtarisë policore

Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i ndalohet të kryejë veprimtari të karakterit policor.

Neni 22

Ndalimi i veprimtarisë jashtë misionit

Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i ndalohet të kryejë veprime për të realizuar qëllime e objektiva që nuk kanë lidhje me misionin e saj.

Neni 23

Informacionet

1. Informacionet e grumbulluara nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nuk përbëjnë bazë ligjore për kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, si dhe të interesave të personave fizikë e juridikë.

2. Ndalohet përdorimi i informacioneve të përfutuara nga veprimtaria informative e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për qëllime përfitimi vetjak apo qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 24

Ruajtja e informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i përftuar nga veprimtaria informative e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është i detyruar të ruajë informacionin e

klasifikuar gjatë dhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Personi që, për shkak të detyrës, është njohur me informacionin e klasifikuar të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, ka për detyrë ta mbrojë atë në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar.

4. Për rastet e shkeljes së detyrimit të përmendur në pikën 2, të këtij neni, kur nuk përbën vepër penale, ndaj personave përgjegjës merren masa disiplinore, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 25

Përjashtimi nga publikimi

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ndalohej të japë informacion që ka të bëjë me të dhëna të klasifikuara dhe përjashtohet nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të të dhënave, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve, të emrave, si dhe të numrit të punonjësve të kësaj Agjencie.

2. Autoritetet, subjektet dhe individët që njihen me informacione të përfutuara nga veprimtaria e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, e kanë të ndaluar, për çdo lloj motivi, dhënien, keqpërdorimin apo bërjen publike të tyre.

Neni 26

Mbikëqyrja dhe kontrolli

1. Ndaj Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ushtrohet mbikëqyrje parlamentare, kontroll administrativ, financiar dhe ligjor në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi.

2. Autoritetet që ushtrojnë mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë së Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes janë:

a) Kuvendi, i cili ushtron mbikëqyrje parlamentare mbi veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

b) Kryeministri, i cili ushtron kontroll mbi veprimtarinë, si dhe kontroll financiar në programimin dhe përdorimin e fondit specifik operativ të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

c) Ministri i Mbrojtjes, i cili ushtron kontroll të drejtpërdrejtë dhe të plotë administrativ, financiar dhe operacional mbi veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

ç) Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, i cili ushtron kontroll për veprimtarinë e kësaj Agjencie personalisht ose nëpërmjet punonjësve të autorizuar prej tij.

3. Ministri i Mbrojtjes ose Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, i autorizuar prej tij, raporton për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në komisionin apo nënkomisionin përgjegjës parlamentar, lidhur me çështjet e sigurisë dhe të inteligjencës, të paktën një herë në vit, si dhe sa herë që kërkohet prej tyre.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i paraqet, çdo vit, Ministrin të Mbrojtjes raport për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe zbatimin e detyrave të ngarkuara.

5. Mbikëqyrja, kontrolli i ushtruar dhe raportimet e bëra nga autoritetet e sipërpërmendura kryhen duke ruajtur burimet dhe informacionet e klasifikuara, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV

STATUSI I PUNONJËSIT TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Neni 27

Fitimi dhe humbja e statusit

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes gëzon status të veçantë, sipas këtij ligji.

2. Këtë status e fiton:

a) punonjësi ushtarak dhe civili Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në detyrë;

b) punonjësi në rezervë, në lirim ose në pension, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përveç të drejtave dhe detyrimeve

që ka, sipas këtij ligji, ka dhe të drejtat e detyrimit që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për ushtarakun e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes e humbet statusin në rastet kur:

- a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- b) ndërpret marrëdhëniet e punës me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pa shkaqe ligjore.

Neni 28

Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

1. Punonjës i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është vetëm shtetasi shqiptar, ushtarak ose civil, që shërben në strukturat e kësaj agjencie.

2. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për përparimin në gradë, karrierë dhe daljen në rezervë apo lirim nga shërbimi ushtarak trajtohet sipas legjislacionit në fuqi për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Punonjësit civilë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përbëjnë jo më shumë se 40 për qind të numrit të përgjithshëm të punonjësve të kësaj Agjencie.

4. Detyrat funksionale dhe përshkrimet e vendit të punës së punonjësve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përcaktohen dhe miratohen me rregullore nga Drejtori i Përgjithshëm.

5. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes duhet të kryejë kursin bazë në Institutin e Shërbimit Informativ të Shtetit. Kursi bazë në Institutin e Shërbimit Informativ të Shtetit organizohet me urdhër të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 29

Klasifikimi i funksioneve

1. Funksionet në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes klasifikohen, si më poshtë:

- a) funksion i nivelit të lartë drejtues;
- b) funksion i nivelit të mesëm drejtues;
- c) funksion i nivelit të ulët drejtues;
- ç) funksion i nivelit ekzekutues;
- d) funksion i nivelit mbështetës.

2. Funksion i nivelit të lartë drejtues është Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Funksione të nivelit të mesëm drejtues janë:

- a) zëvendës drejtor i përgjithshëm;
- b) drejtor drejtorie.

4. Funksion i nivelit të ulët drejtues është përgjegjës sektori.

5. Funksione të nivelit ekzekutues janë:

- a) specialist;
- b) analist;
- c) inspektor.

6. Funksion i nivelit mbështetës është ndihmësinsektor.

Neni 30

Kriteret e pranimit

1. Për t'u pranuar në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, ushtaraku ose civili ekuivalent duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme:

- a) të jetë vetëm shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor;
- ç) të ketë gradën për vendin përkatës të punës;
- d) të jetë i aftë nga ana shëndetësore;

- dh) të mos jetë dënues me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - e) të mos jetë larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike;
 - ë) të plotësojë kushtin e sigurisë;
 - f) të mos ketë filluar ndjekja penale ndaj tij;
 - g) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të detyrës në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - gj) të mos ketë konflikt interesi me detyrën ose funksionin që do të kryejë.
 - h) të ketë qëndrim jo më pak se 5 vitet e fundit në Shqipëri, përjashtuar personin që është dërguar jashtë shtetit në përfaqësi ose mision ushtarak apo diplomatik, si dhe për studime nga Ministria e Mbrojtjes ose nga institucione të tjera shtetërore, që kanë objekt të veprimtarisë së tyre çështje të sigurisë ose të mbrojtjes.
2. Personat që punësohen në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, krahas kërkesave të përgjithshme, duhet të plotësojnë kushtin e sigurisë dhe disa kritere të veçanta, për raste e për profesione specifike.
 3. Verifikimi i kushtit të sigurisë zbatohet ndaj personit që kërkon të punësohet në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si dhe për lidhjet e tij me personat e familjes ose jashtë saj. Personat që nuk plotësojnë kushtin e sigurisë nuk mund të lidhin ose të kenë marrëdhënie pune me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.
 4. Kriteret për plotësimin e kushtit të sigurisë përcaktohen me rregullore, të miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 31

Procedura e pranimit të punonjësit

1. Punonjësi ushtarak që do të pranohet në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përzgjidhet nga ushtarakët e Forcave të Armatosura, sipas kriterëve të arsimit, kualifikimit dhe kriterëve të vendit të punës, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.
2. Pranimi i punonjësve civilë në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes bëhet me konkurrim.
3. Shpallja e vendit të lirë të punës bëhet nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në dy gazeta me qarkullim të madh kombëtar, të paktën, 30 ditë para datës së caktuar për konkurrim. Shpallja përmban vetëm kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati, ndërsa njoftimi për specialitetin, për të cilin do të zhvillohet konkurrimi, kryhet në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.
4. Pranimi në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në raste të veçanta, mund të kryhet pa konkurrim, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie dhe me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.
5. Rastet e veçanta dhe profesionet specifike përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 32

Komisioni i testimit

1. Komisioni i testimit në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes zhvillon testimin e ushtarakëve ose civilëve që do të pranohen në këtë agjenci, pas verifikimit paraprak të dokumentacionit nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore, si dhe pas kryerjes së procesit të plotësimit të kushtit të sigurisë nga struktura përgjegjëse e sigurisë.
2. Komisioni i testimit përzgjedh ushtarakun ose civilin që do të punësohet në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pasi ka kryer:
 - a) testimin me shkrim;
 - b) intervistën me gojë.
3. Komisioni i testimit ngrihet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Procedurat dhe rregullat e funksionimit të komisionit të testimit përcaktohen me rregullore të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 33

Periudha e provës

1. Punonjësi, ushtarak dhe civil, që pranohet të punësohet në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i nënshtrohet një periudhe prove prej 6 muajsh, e cila fillon nga data e emërimit. Gjatë kësaj periudhe punonjësi

është nën kujdesin e eprorit të tij dhe vlerësohet nga ky i fundit. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe punonjësi duhet të kryejë kursin bazë në qendrën e trajnimit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. Në fund të periudhës së provës, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i propozon Ministrit të Mbrojtjes për punonjësin ushtarak dhe civil në kompetencë të tij:

- a) emërimin në detyrë si punonjës i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë;
- c) lirimimin ose shkarkimin nga detyra.

3. Në fund të periudhës së provës, eprori i drejtpërdrejtë i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për punonjësin civil në kompetencë të tij:

- a) emërimin në detyrë si punonjës i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë;
- c) lirimimin ose shkarkimin nga detyra.

4. Punonjësi në periudhë prove gëzon të drejtat dhe detyrimet e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 34

Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i punonjësit

1. Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i punonjësit ushtarak oficer ose i punonjësit civil ekuivalent me të, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve, bëhet nga Ministri i Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i punonjësit ushtarak nënoficer, ushtar, ose i punonjësit civil ekuivalent me ta, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve, bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me propozim të komisionit të testimit.

Neni 35

Vjetërsia në punë, për efekt pensioni të parakohshëm për vjetërsi shërbimi

Vjetërsi në punë e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për efekt pensioni të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, njihet:

- a) koha nga data e pranimit deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- b) koha e punës në struktura të tjera që përfitojnë sigurime shoqërore suplementare;
- c) koha e ndërprerjes së karrierës në shërbim, për shkak të një vendimi të padrejtë, të cilësuar si të tillë nga gjykata.

Neni 36

Vlerësimi i punës

1. Vlerësimi i punës së punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes bëhet një herë në vit, si dhe në rastet e mbarimit të periudhës së provës.

2. Procedurat e vlerësimit për punonjësin civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie.

3. Shkallët e vlerësimit për punonjësin civil janë:

- a) “shumë mirë”;
- b) “mirë”;
- c) “mjaftueshëm”;
- ç) “jo mjaftueshëm”.

4. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes vlerësohet sipas procedurave të vlerësimit që aplikohen për ushtarakun e Forcave të Armatosura.

Neni 37

Karriera dhe ngritja në detyrë e punonjësit civil

1. Punonjësi civil i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përparon në karrierë dhe mund të ngrihet në detyrë në një pozicion të një niveli më të lartë, kur një vend i tillë ekziston, në bazë të meritave e përvojës në punë dhe kur vlerësimet për punën e kryer janë në shkallën “shumë mirë”.

2. Punonjësi që ka masë disiplinore të pashlyer nuk mund të ngrihet në detyrë.

3. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për të përparuar në karrierë dhe për t'u ngritur në detyrë në një pozicion të një niveli më të lartë, duhet të ketë këtë përvojë pune:

- a) jo më pak se 3 vjet, kur është punonjës në funksion ekzekutues;
- b) jo më pak se 5 vjet, kur është drejtues i nivelit të ulët;
- c) jo më pak se 10 vjet, kur është drejtues i nivelit të mesëm, drejtor drejtorie, në struktura të inteligjencës ushtarake ose civile apo në institucione me natyrë të ngjashme me to.

Neni 38

Komandimi

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, oficer dhe civil, ekuivalent sipas tabelës së orgaizimit e pajisjeve, për nevoja pune, mund të komandohet në një detyrë tjetër, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, për një periudhë jo më shumë se 6 muaj.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, nënoficer, ushtar dhe civil, ekuivalent me ta sipas tabelës së organizimit e pajisjeve, për nevoja pune, mund të komandohet në një detyrë tjetër, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie për një periudhë jo më shumë se 6 muaj.

3. Gjatë kohës së komandimit, punonjësit i ruhet vendi i punës dhe trajtohet me pagën e vendit të punës që ka pasur para komandimit.

Neni 39

Pezullimi i punonjësit

1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënieve të punës, për sa kohë zgjat arsyeja e ndërprerjes. Në përfundim të periudhës së pezullimit punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion tjetër të të njëjtit nivel me detyrën e mëparshme, me përjashtim të rastit kur dënohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

2. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pezullohet nga detyra sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura.

3. Pezullimi i punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes bëhet me urdhër të autoritetit që e ka emëruar, në rastet kur:

- a) ndaj tij fillon ndjekja penale, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata;
- b) ndjek studimet me nismën e vet, për më shumë se 6 muaj, dhe në lidhje me profesionin që ai ushtron. Periudha e studimeve nuk mund të jetë më shumë se 2 vjet.

4. Gjatë periudhës së pezullimit punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nuk paguhet. Në rastin e parashikuar në shkronjën "a", të pikës 3, të këtij neni, kur çështja penale pushohet ose kur me vendim gjykate të formës së prerë deklarohet i pafajshëm, punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i jepet paga bazë që nga momenti i pezullimit.

Neni 40

Lirimi ose shkarkimi nga detyra

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, oficer ose civil ekuivalent, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, nënoficer, ushtar ose civil ekuivalent, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes lirohet nga detyra në rastet kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) mbush moshën për pension të plotë pleqërie;
- c) bëhet i paaftë përgjithmonë për kryerjen e detyrave, për shkak të kushteve shëndetësore;
- ç) nuk mund të ushtrojë detyrën për një periudhë kohore më të gjatë se 6 muaj për pamundësi fizike dhe shëndetësore;
- d) ka ristrukturim ose shkurtim funksioni organik;
- dh) vlerësohet dy herë rresht "jo mjaftueshëm";
- e) nuk pranon të emërohet në një detyrë tjetër;

- ë) përfundon kontratën e punës;
- f) ka konflikt interesi me detyrën që kryen;
- g) nuk pajiset ose i hiqet “certifikata e sigurisë”.

4. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes shkarkohet nga detyra në rastet kur:

- a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- b) për shkelje të rënda disiplinore;
- c) për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij dhe të institucionit.

5. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nxirret në rezervë apo lirim nga shërbimi ushtarak, sipas legjislacionit në fuqi për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në momentin që lirohet ose shkarkohet nga detyra, dorëzon menjëherë detyrën.

KREU V

DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E PUNONJËSIT TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Neni 41

Detyrat kryesore

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ka këto detyra kryesore:

- a) të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
- b) të ushtrojë me përkushtim detyrën dhe të veprojë me profesionalizëm e me përgjegjësi;
- c) të jetë i paanshëm, objektiv dhe i drejtë;
- ç) të mos niset nga interesi i përfitimit personal e të mos krijojë favore për individë të caktuar, duke u kushtëzuar nga motive që nuk lidhen me realizimin me ndërgjegje të detyrës;
- d) të realizojë me besnikëri detyrat e funksionet zyrtare, pavarësisht nga pikëpamja personale dhe të zbatojë me përpikëri urdhrat ose vendimet e organeve eprorë;
- dh) të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e mosveprimet e veta, gjatë ushtrimit të detyrës dhe, kur nuk është i bindur për ligjshmërinë e urdhrave e të vendimeve, të vërë në dijeni menjëherë urdhërdhënësin dhe eprorët e këtij të fundit;
- e) të zbatojë rregullat e etikës së administratës publike.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është i detyruar të kryejë të gjitha detyrat për të cilat është ngarkuar.

Neni 42

Përgjegjësia e punonjësit

Për shkeljen e akteve ligjore e nënligjore të disiplinës në punë dhe për dëme materiale të pronës publike ose private, punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes mban përgjegjësi penale, administrative, materiale apo civile, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 43

Ruajtja e dinjitetit

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është i detyruar të ruajë dinjitetin dhe integritetin e institucionit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

2. Paraqitja në publik, komunikimi dhe veprimet e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përfaqësojnë autoritetin e institucionit.

Neni 44

Asnjënia politike

1. Punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i ndalohet anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtari të partive apo organizatave politike dhe joqeveritare, si dhe kryerja e veprimtarive në favor ose kundër partive, shoqatave politike apo kandidatëve në zgjedhje.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nuk duhet të manifestojë sjellje dhe të mbajë qëndrime që cenojnë natyrën e depolitizuar të institucionit.

Neni 45

Kufizimi i së drejtës së grevës

Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nuk ka të drejtë të bëjë grevë, si dhe të bëjë kërkesa e ankesa kolektive.

Neni 46

Ruajtja e aktiveve

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është i detyruar të ruajë e të mirëmbajë mjediset e punës dhe mjetet e dhëna në përdorim për kryerjen e detyrës.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përgjigjet për dëmin që u shkakton, me dashje apo nga pakujdesia, aktiveve të agjencisë. Në këtë rast, brenda 6 muajve nga data e zbulimit të dëmit, por jo më vonë se 3 vjet nga data e shkakimit të dëmit, nxirret urdhri i zhdëmtimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Kundër urdhrat të zhdëmtimit punonjësi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente.

Neni 47

Dëmi i shkaktuar të tretëve

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar nga punonjësi i kësaj agjencie, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj ndaj personave fizikë e juridikë.

2. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas rrethanave, kërkon nga punonjësi përgjegjës për dëmin e shkaktuar shpenzimet e zhdëmtimit.

3. Për përgjegjësinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përgjegjësinë vetjake të punonjësve të saj, rastet e shkakimit të dëmit ndaj personave fizikë e juridikë, privatë, si dhe dëmshpërblimin e dëmeve të shkaktuara zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore.

Neni 48

Kufizimi i lirisë së lëvizjes

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ka të drejtë të dalë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm me leje me shkrim të Ministrit të Mbrojtjes ose personit të autorizuar prej tij.

2. Procedurat dhe rregullat për dhënien e lejeve për punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie.

Neni 49

Paga dhe shtesat mbi pagë

1. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes trajtohet me pagë si ushtarakët e Forcave të Armatosura.

2. Paga mujore e punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është sipas legjislacionit në fuqi që përcakton pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese e institucioneve të tjera, të pavarura, të krijuara me ligj, si institucion qendror në varësi të ministrisë së linjës.

3. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes trajtohet për natyrë të veçantë pune dhe vështirësi shërbimi, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 50

Sigurimet shoqërore suplementare

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përveç përfitimeve që rrjedhin nga legjislacioni për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, gëzon të drejtën e përfitimeve të tjera shtesë, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin përkatës për sigurimet shoqërore suplementare.

2. Për efekt të përfitimit të sigurimeve shoqërore suplementare, si vjetërsi shërbimi njihet periudha nga momenti

i emërimit deri në momentin e lirit ose shkarkimit nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 51

Kohëzgjatja e punës

1. Kohëzgjatja normale e punës për punonjës in e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes njësohet me atë të punonjësve të administratës publike.

2. Për nevoja të punës dhe interesa të shërbimit, koha e punës mund të zgjatet tej kohës normale me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ose të eprorit të punonjës it. Në këto raste, punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 52

Kohëzgjatja e pushimit

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes gëzon të drejtën e pushimit javor, të pushimit vjetor të paguar dhe të pushimeve të tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.

2. Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar për punonjës in ushtarak dhe civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është 45 ditë kalendarike.

3. Kur pushimi vjetor për punonjës in e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për arsye pune ose shërbimi, nuk jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se në muajin mars të vitit pasardhës, në të kundërt paguhet për lejen e pakryer.

4. Kur punonjësi, gjatë kryerjes së lejes së pagueshme vjetore, për arsye shëndetësore bëhet i paaftë për punë, e vërtetuar kjo me raport mjekësor, ai njofton Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe pushimi vjetor i zgjatet për atë periudhë kohe.

5. Në rast të martesës së tij ose të pjesëtarëve të familjes apo në rast fatkeqësie familjare ose sëmundjeje të rëndë të pjesëtarëve të familjes dhe në raste të tjera të ngjashme me to, punonjës it të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie i jepen deri në 5 ditë leje të pagueshme ose deri në 45 ditë leje pa të drejtë page.

Neni 53

Dokumenti i identifikimit dhe armatimi

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pajiset me dokument zyrtar identifikimi.

2. Forma e dokumentit të identifikimit miratohet nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas funksioneve të veçanta, të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i kësaj Agjencie, pajiset me armatim personal, të cilin e mban dhe e përdor në përputhje me legjislacionin në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit.

4. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, kur ndërpret marrëdhëniet e punës, dorëzon menjëherë dokumentin e identifikimit dhe armatimin përkatës.

5. Kur punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes vdes, familjarët e tij dorëzojnë dokumentin e identifikimit dhe armatimin e tij, brenda 30 ditëve, në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 54

Uniforma

1. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në varësi të natyrës së detyrës ose operacioneve, mban uniformë ushtarake a veshje civile.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes trajtohet me veshmbathje në vlerë leku, një herë në vit, në masën e gjysmës së pagës mujore të vendit të punës.

Neni 55

Mbrojtja e veçantë ligjore

1. Kur punonjës it të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për shkak të ushtrimit të detyrës, i kërcënohet jeta, shëndeti, familja apo prona, i garantohet mbrojtje e veçantë ligjore me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie.

2. Mënyrat dhe kriteret e mbrojtjes së veçantë ligjore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

KREU VI

MBROJTJA SHOQËRORE PËR PUNONJËSIN CIVILË TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Neni 56

Trajtimi i familjarëve të personit që humbet jetën në detyrë ose për shkak të saj

1. Familja e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, që humbet jetën në detyrë ose për shkak të saj, si dhe familja e personit që ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi të fshehtë me këtë agjenci dhe humbet jetën për shkak të këtij bashkëpunimi, përfiton kompensim të veçantë.

2. Kriteret dhe masa e përfitimit të kompensimit, për shkak të humbjes së jetës në detyrë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 57

Mbështetja arsimore

Fëmijët e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, që ka humbur jetën në detyrë ose për shkak të saj, kur fitojnë të drejtën e ndjekjes së studimeve në institucionet publike shtetërore të arsimit të lartë brenda vendit, përfitojnë nga shteti bursë të plotë, brenda kuotave të përgjithshme të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, për vitin akademik përkatës.

Neni 58

Ndihma financiare në raste vdekjeje, sëmundjeje ose fatkeqësie

1. Kur punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes vdes, sëmuret rëndë e për një kohë të gjatë, të vërtetuar me raport mjekësor, ose pëson dëmtime të rënda të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore, familjes ose atij i jepet ndihmë financiare e menjëhershme, në masën deri në 6 paga mujore.

2. Punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i jepet ndihmë financiare e menjëhershme, në masën deri në 3 paga mujore, kur njëri nga familjarët në ngarkim të tij është i sëmurë rëndë dhe për një kohë të gjatë ose vdes.

3. Kur punonjësi në detyrë i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes vdes, kjo agjenci organizon ceremoninë e rastit dhe përballon shpenzimet e varrimit.

4. Kriteret dhe masa e përfitimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes.

KREU VII

DISIPLINA PËR PUNONJËSIT CIVILË TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Neni 59

Disiplina

1. Punonjësve civilë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes u jepen masa disiplinore për mosplotësimin e detyrave, për thyerje të disiplinës në punë e të rregullave të etikës, për shkelje të akteve ligjore e nënligjore, si dhe për raste të tjera të parashikuara nga ky ligj.

2. Masat disiplinore jepen sipas një procedure administrative, e cila garanton të drejtën për t'u vënë në dijeni, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar. Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, miraton rregulloren e disiplinës për punonjësit civilë, kërkesat e së cilës janë të detyrueshme për zbatim.

3. Masat disiplinore jepen për punonjësin civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, kur veprimet dhe mosveprimet e tij nuk përbëjnë vepër penale.

4. Për punonjësin ushtarak të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes zbatohet legjislacioni në fuqi për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 60

Llojet e masave disiplinore

Llojet e masave disiplinore për punonjësit civilë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes janë:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) kalim në një detyrë të një niveli ose klase më të ulët për një periudhë deri në një vit;
- ç) lirim ose shkarkim nga detyra.

Neni 61

Dhënia e masës disiplinore dhe shlyerja e saj për punonjësin civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

1. Procedimi disiplinor për punonjësin civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes fillon jo më vonë se 30 ditë nga çasti i konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se një vit nga çasti i kryerjes së saj.

2. Nismën për fillimin e procedimit disiplinor e ndërmerr eprori direkt i punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, i cili i propozon Drejtorit të Përgjithshëm fillimin e ecurisë disiplinore. Drejtori i Përgjithshëm vendos për ngritjen e komisionit disiplinor. Komisioni disiplinor, pasi njihet me dokumentacionin dhe faktet për shkeljen e pretenduar, i propozon Ministrit të Mbrojtjes ose Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas përkatësisë së emërimit të punonjësit, dhënien e masës disiplinore ose pushimin e çështjes. Pas propozimit të komisionit disiplinor, Ministri i Mbrojtjes ose Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, vendos dhënien, mosdhënien ose ndryshimin e masës.

3. Masat disiplinore jepen në mënyrë të shkallëzuar ose sipas rëndësisë së shkeljes dhe të pasojave. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.

4. Vendimi për marrjen e masës disiplinore i komunikohet, me shkrim, të interesuarit.

5. Masat e përcaktuara në nenin 60 të këtij ligji, me përjashtim të masave të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të tij, shlyhen, nëse brenda një viti nga data e dhënies së tyre ndaj personit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake.

Neni 62

Njohja me dokumentacionin e procedimit

1. Punonjësit civil të proceduar i jepet dokumentacioni i procedimit të nisur në ngarkim të tij 3 ditë para shqyrtimit të shkeljes nga komisioni disiplinor, për rë pasur mundësi për të përgatitur mbrojtjen.

2. Punonjësi civil i proceduar njoftohet për datën kur do të shqyrtohen materialet që lidhen me të, jo më vonë se 5 ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit për përgatitjen e mbrojtjes.

Neni 63

E drejta për t'u dëgjuar

1. Punonjësi civil, ndaj të cilit ka nisur procedimi disiplinor, ka të drejtë të mbrohet, duke u paraqitur vetë para komisionit disiplinor, i cili është i detyruar ta dëgjojë dhe të verifikojë pretendimet e ngritura.

2. Mosparaqitja, pa shkaqe të arsyeshme, e punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në seancën dëgjimore nuk e pengon komisionin disiplinor të shqyrtojë çështjen dhe të nxjerrë përfundimet përkatëse.

Neni 64

Marrja e masës disiplinore

Komisioni disiplinor shprehet brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit të paraqitjes së pretendimeve nga punonjësi civil i proceduar disiplinarisht.

Neni 65

Ankimi

1. Punonjësi civil ka të drejtë të ankohet te Ministri i Mbrojtjes, kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm për dhënien e masës disiplinore, sipas shkronjës “ç”, të nenit 60, të këtij ligji, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të saj. Ministri i Mbrojtjes vendos lënien në fuqi, mosdhënien ose ndryshimin e masës.

2. Punonjësi civil, të cilit i është dhënë masë disiplinore, sipas shkronjës “ç”, të nenit 60, të këtij ligji, nga Ministri i Mbrojtjes ose Drejtori i Përgjithshëm, ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga njoftimi.

KREU VIII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 66

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen për nxjerrjen e akteve nënligjore brenda 6 muajve:

- a) Këshilli i Ministrave, në zbatim të neneve 6, pika 2; 19, pika 4; 20, pika 3; 49, pika 3; 55, pika 2, dhe 58, pika 4, të këtij ligji;
- b) Kryeministri, në zbatim të nenit 6, pika 4, të këtij ligji;
- c) Ministri i Mbrojtjes, në zbatim të neneve 8, pika 3, shkronja “gj”; 16, pika 3; 18, pika 2; 19, pika 2; 30, pika 4, 31, pika 5; 32, pika 3; 36, pika 2; 48, pika 2; 53, pika 2; dhe 59, pika 2, të këtij ligji.

Neni 67

Shfuqizime

Ligji nr. 117/2012, “Për Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes”, miratuar në datën 13.12.2012, shfuqizohet.

Neni 68

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.6.2014

KRYETARI
Ilir Meta